



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 36 paragrafi 1, nenin 40 dhe neni 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar për denoncimin për korrupsion nga parashtrues i njohur – person juridik, në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

#### VENDIM

Procedura e ngritur pas denoncimit për korrupsion nr. 12-4561/1 me datë 01.10.2019 dorëzuar nga parashtrues i njohur, ..... në Republikën e Maqedonisë së Veriut, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-4561 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-4561/1 me datë 01.10.2019.

Lënda me numër 12-4561 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Mostër nga vendimi të dorëzohet deri tek parashtruesi i denoncimit.

#### SQARIM

Lënda me numër 12-4561 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-4561/1 me datë 01.10.2019, dorëzuar nga parashtrues i njohur ..... i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Denoncimi i lëndës – propozim për veprim, ka të bëjë me veprime koprruptive dhe keqpërdorime të procedurës për regjistrim të kandidatëve për student në Universitetin ....., më konkretisht për regjistrim të kandidatëve për student jashta shtetit – Republika e .....

Gjatë veprimit në denoncimin e rastit të lëndës, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke u nisur nga akuzat e parashtruesit, me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike, bëri disa kontrole adekuate administrative në lidhje me besueshmërinë e tyre dhe mbështetjen në mënyrë që të ndërmer veprime procesuese – dorëzimi i kërkesës për të dhëna dhe informacione – me shtojcë dokumentacion me theks të veçantë në procedurën për nënshkrim të Kontartës për bashkëpunim nr. ...., me personin juridik në pronësi private, ndërmarrja për konsultime – Agjensionin ..... nga Republika e ..... - duke përfshirë edhe dorëzimi të kopjes së kontratës së nënshkruar; shfaqja e lëndës dhe vlerës së Kontratës së nënshkruar për bashkëpunim, ..... me Agjensionin ..... nga Republika e ....., arsyet për kontraktimin të kandidatëve për studentë si dhe për

studiim të gjuhës maqedonase në Universitet, për lartësinë e shpenzimeve për regjistrim të kandidatëve për studime dhe të studiim të gjuhës maqedonase në Universitetin ..... dhe vlerën e shpenzimeve për regjistrim të kandidatëve për studime për studim të gjuhës maqedonase, kurse me ndërmjetësim të Agjensionit ..... nga Republika e ..... edhe për numrin e kandidatëve për studentë nga Republika e ..... të cilët janë regjistruar në Universitetin ..... në ..... në vitin ..... me ndërmejtësimin e Agjensionit të përmendur, si dhe se valla kontrata e lëndës është ende në funksion dhe vallë a po aplikohet ende.

Rrejdhimisht, me qëllimin e dorëzimit të kërkesës, deri Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit është dorëzuar përgjigje me shkrim nga ..... në ..... me shtojcë dokumentacion, nga të cilat vërehet se nënshkrimi i kontratës i ka paraprirë miratimi i Vendimit të Administratës së Rektoratit të Universitetit e cila është me datë ..... – për pëlqim të hapjes së Katedrës së gjuhës maqedonase pranë ..... në ....., R. .... dhe për nënshkrimin e kontratës për bashkëpunim, si dhe miratimi i Vendimit të senatit të Universitetit me ..... – për pëlqim të Kontratës për bashkëpunim.

Sipas shprehjes së Universitetit, vendimet e përmendura dhe kontrata e nënshkruar me qëllim të studimit të gjuhës maqedonase në ..... – katedra e cila është themeluar, në pajtim me strategjinë e ..... me qëllim të rritjes së numrin të studentëve të huaj në këtë shtet Universiteti, përshakk të internacionalizimit më të madhë, si dhe me qëllim të afirmimit të gjuhës maqedonase në ..... përveç kësaj me themelimin e kësaj mënyre të studimit të gjuhës maqedonase, mendon se është themeluar mënyra e dytë e studimit të gjuhës maqedonase, përveç asaj mënyre ekzistuese, në kuadër të Institutit për gjuhë të huaja në Universitetin – me procedurë të njëjtë.

Nga universiteti, gjithashtu sqarojnë se në Institutin pranë ..... studentët e huaj studiojnë gjuhën maqedone me kompenzim të vlerës prej 1000 euro për ndjekje të dy kurseve – për certifikatë A1 dhe A2, gjegjësisht se në lidhje me studimin e gjuhës maqedonase në ..... është paraparë, kurse edhe me kontratën është rregulluar, Agjensioni i përmendur për të dy kurset t'i paguan Universitetit nga 1200 euro për çdo kandidat dhe se gjatë asaj, dallimi nga 200 euro ka të bëjë me mbulimin e shpenzimeve të Komisionit e cila do t'i realizon provimet në kuadër të Katedrës për gjuhën maqedonase pranë ..... Universitetit në .....

Me kontratën e nënshkruar me datë ..... është paraparë që kursi të realizohej nga ana e lektorëve nga gjuha maqedonase të Institutit pranë ....., kurse vendosjen e lektorëve t'a siguron së bashku me shpenzimet për vendosje t'i mbulon "Agjensioni", gjegjësisht provimet e lëndëve të zhvillohen para Komisionit nga Qendra për gjuhë të huaja pranë ....., kurse janë të rregulluara edhe tjerat, çështjet procedurale, si dhe nostrifikimi i diplomës nga shkollimi i mesëm dhe statusi i "Agjensionit" – si përfaqësues i vetëm për organizimin e studimit të gjuhës maqedonase të personave nga Republika e .....

Në shtojcën me përgjigjen derit ek Komisioni shtetëror janë dorëzuar edhe shkrime – lista përfundimtare e studentëve të huaj, libri i certifikateve, personat përgjegjës për praninë të dokumentave, si dhe Lajmërime me datë ..... deri tek "Agjensioni" për ndërprerje të kontratës me të cilën si arsye të ndërprerjes theksohet fakti që Katedra për gjuhën maqedonase pranë ..... në ..... "ende nuk është në funksion".

Njëkohësisht, me shprehjen dhënë në përgjigjen me shkrim Universiteti thirret edhe në inspektimin mbikqyrës të bërë nga Inspektorati shtetëror i arsimit, me shtojcë procesverbale nga mbikqyrja, nga të cilët vërehet se nga inspektorati nuk janë konstatuar shkelje të procedurës.

Nga të gjitha shkrimet e marra del se kontrata mundëson udhëtim të lektorëve dhe persoanve tjerë në ....., me kompensim të shpenzimeve për vendosje nga "Agjensioni" dhe nënshkrimi saj mund të llogaritet si i arsyeshëm nga aspekti i pagesës nga 1200 euro për kandidat nga ana e "Agjensionit" me potencial të rritet numri i studentëve të hauj – nga Turqia, në ..... megjithatë ngel fakti se Universiteti e ka ndërpresë kontratën deri në aktivizimin e Katedrës për gjuhën maqedonase.

Duke pasë parasyshë të shënuarën më lartë Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit konstaton se akuzat e denoncimit të lëndës nuk janë vërtetuar dhe nuk ka indicje për keqpërdorim të funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për realizim të interesit të drjtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmejtësuesit, për vete ose për tjerë të personave zyrtarë/përgjegjës të Universitetit ..... në ....., dhe prej këtu dhe se Komision shtetëror nuk ka bazë për veprim kompetent të mëtutjeshëm në përputhje me kompetencat e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit të caktuara me nenin 17 të Ligjit përparandalim të korrupsionit.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më sipër, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit, vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Ky vendim është i prerë dhe kundër këtij nuk është e lejuar aneksa.

Vendimi është miratuar me datë 19 shkurt 2021 me numër ..... / .....

**KOMISIONI SHTETËROR PËR  
PARANDALIM TË KORRUPSIONIT  
Zëvendës-Kryetarë: m-r Shemshi Sallai**

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: H. M., këshilltarë

Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

Dorëzuar deri tek: Arkiva, parashtuesi